



Kombetarja shqiptare e femrave ne futboll u mund 0-4 nga perfaqesuesja holandeze, ndeshja e dyte ne eliminatoret e botërorit Kanada 2015 dhe e para zyrtarisht për to përballë tifozëve kuqezinj. Kjo humbje ishte e parashikueshme pasi përballë shqiptarëve futbolliste ishin një skuadër që ka një traditë të madhe në këtë sport mashkullor që luhet mjaft mirë edhe nga femrat. Tulipanet shënuan 2 herë brenda 7 minutave të para me Gabriela Maria Melis. Sulmuesja e skuadës suedeze të Malmos shënoi golin e tretë personal dhe të tretin për Holandën në fillimin e pjesës së dytë. Në minuten e fundit të ndeshjes Astrid vulosi fitoren e thellë të holandezeve. Ndeshjet e radhës për Shqipërinë janë ndaj Greqisë dhe Portugalisë ku mund të synohet ndonjë rezultat pozitiv.